

RELACION

***PER OBJEKTIN " NDERTIM PARKIMI PER MJETET E PASTRIMIT DHE
STREH PER QENTE NE LANDFILLIN BERAT"***

ME VENDODHJA: BASHKIA BERAT

INVESTITORI: BASHKIA BERAT

PUNOI: Ing.Arjana Marini

QERSHOR 2024

TE PERGJITHSHME

PERSHKRIMI I PRONES.

Prona ku do te ndertohet objekti "Ndertim parkimi per mjetet e pastrimit dhe streh per qente ne landfillin Berat" ndodhet ne fshatin **Dushnik** Njesia Administrative Otllak, bashkia BERAT.

Te dhëna për objektin qe do të ndertohet.

Ne projektin e zbatimit eshte projektuar te ndertohen dy objekte ne vende te larguara nga njeri tjetri.

Objekti I pare , Ndertim parkimi.

Objekti i pare ,ndertimi i parkimit ka nje sipefaqe totale te ndertimit 207 m^2 me lartesi maksimale 4.5 m nga kuota $+0.00$ e objektit.

Objekti i parkimit do te jete me konstruksion mbajtes metalik, mbulese e mure perimetrale me panele sanduic.

Themeli do te realizohet me plinta betoni me permasa $1.4x1.4x1.4\text{m}$ me beton C16/20 kg/cm 2 te cilat do te armohen me hekur periodik $\varphi 12$ ndersa traret e themelit do te armohen me hekur periodik $\varphi 16$ sipas percaktimeve te pasqyruara ne projektin konstruktiv.

Trashesia e plintave do jete 50cm per prerjen e pare si dhe 50cm per prerjen e dyte duke bere qe lartesia totale e plintit te shkoje ne 100cm .

Plintat do te armohen me zgare $\varnothing 12/10\text{cm}$ dhe betoni i perdonur per betonimin e tyre do te jete i markes C20/25 ose M-250.

Perpara betonimit te plintave do te fiksohen me kujdes dhe saktesi te madhe pllaka metalike me prizhoneret metalike te cilet do te sherbejne per mberthimin e kollonave metalike ne themel.

Shtresa e dyshemesë do të bëhet me një shtrese betoni me trashesi 20cm me zgare metalike me hekur ϕ 8 cdo 20cm.

Objekti do jete pa kollona ne mes, pasi struktura e mbuleses prej sanduici do te mbeshtetet ne te dy faqet anesore mbi kollonat metalike.

Ne funksion te parkimit eshte menduar te ndertohet edhe një gropë per riparimet e vogla te mjeteve te pastrimit. Gropa do te jete me mure b/a me trashesi 20cm e armuar me hekur ϕ 10mm nga te dyja anet dhe do te kete permasa si ne vizatim. Ne funksion te parkimit eshte parashikuar edhe çpimi i një pusi me thellesi deri ne 30m per te mundesuar furnizimin me uje te objektit.

Lartesia e katit perdhe do jete 4.5ml dysheme-faqe anesore ku dyshemeja do jete me trashesi 20cm. Dyshemeja do shtrohet me beton te markes M-250 dhe do perpunohet me helikopter pasi ambienti do sherbeje si vend pune si dhe qe te jete me e lehte me te lehte per tu pastruar nga papastertite e ndryshme.

Ne projekt jane dhene gjithashtu dhe detajet e nyjes se kulmit, te kembes se kapriates, te mberthimit te kapriates me plintin si dhe te fiksimit te arkarexhit me kapriaten metalike.

Rrjeti elektrik dhe ai hidraulik do behet komplet me materiale importi te cilesise se pare per tju pershtatur sa me mire kerkesave te kohes dhe standarteve te sotme si dhe profilit te punes qe do kryhet ne kete objekt.

Ne pjesen e jashtme te hyrjes per ne magazine do vendosen porta metalike sipas projektit arkitektonik me hapje te telekomanduar me gjeresi 4m dhe lartesi 3m, meqenese objekti do kete funksion industrial.

Per mbulesen e objektit gjithashtu eshte menduar te perdoren panele sanduic me tarshesi 3cm ashtu sic do perdorim edhe per veshjen anesore, e cila do kete te vendosur anash saj dhe ulluqet horizontale dhe vertikale per largimin e ujrave te bardha nga mbulesa.

Per te larguar ujrat e bardha eshte menduar qe te vendosen ulluqe horizontale me spesor 0.8mm dhe ato vertikale prej bakri me spesor po 0.8mm dhe me diameter 100mm te cilat do fiksohen me aksesoret metalikeperkates .

OBJEKTI I DYTE

Objekti I dyte eshte projektuar nje strehes per qente.

Streheza eshte me permasa 48x3m . me nje siperfaqe 144m². Dhe lartesi maksimale 2.20m.

Konstruksioni mbajtes do te jete me profile metalike sipas permasave ne fletet e vizatimit, mbulesa do te realozohet me panele sanduiç me trashesi 3cm dhe do te rrethohet me rrjete teli.

Shtresa e dyshemese do te realizohet me beton.

Hyrja ne sheshin e ndertimit

Sipermarresi duhet te organizoje punen per ndertimin, mirembajen dhe me pas te spostoje dhe ta rivendose cdo rruge hyrje qe do te duhet ne lidhje me zbatimin e punimeve. Çvendosja do te perfshije pershatjen e zones me cdo rruge hyrje, qendrushmerie dhe te kullimit te ujrale siperfaqesore te njejtë me ate qe ekzistonte perpara se Sipermarresi te hynte ne Shesh.

Piketimi i objektit.

Sipermarresi, me shpenzimet e tij duhet te beje ndertimin e modinave dhe te piketave sic kerkohet, ne perputhje me informacionin baze te Punedhenesit, dhe do te jete pergjegjesi i vetem per perpikmerine e piketimit te objektit.

Sipermarresi do te jete pergjegjes per te kontrolluar dhe verifikuar informacionin baze qe i eshte dhene dhe ne asnje menyre nuk do te lethesohet nga pergjegjesia e tij ne se nje informacion i tille eshte i manget, jo autentik ose jo korrekt. Ai nderkohe do te jete subjekti qe do te kontrollohet dhe rishikohet nga Punedhenesi, dhe ne asnje rast nuk i jepet e drejta te beje ndryshime ne vizatimet e kontrates , per asnje lloj kompensimi per korrigimet e gabimeve ose te mangesive. Sipermarresi do te furnizoje dhe mirembaje me shpenzimet e tij, rrethimin dhe materiale te tjera te tilla dhe te jape asistenca nepermjet nje stafi te kualifikuar sic mund te kerkohet nga Punedhenesi per kontrollin e modinave dhe piketave.

Sipermarresi do te ruaje te gjitha pikat e akseve, modinat, shenjat e kuotave, te bera ose te vendosura gjate punes, te mbuloje koston e rivendosjes se tyre nese ato demtohen dhe te mbuloje te gjitha shpenzimet per ndreqjen e punes se bere jo mire per shkak te mosmirembajtjes ose spostimit pa autorizim te ketyre pikave te vendosura.

Perpara cdo aktiviteti ndertimor, Sipermarresi do te kete linjat e furnizimit me uje dhe energji elektrike te vendosura ne terren, te drejten e kalimit te qarte dhe te sheshuar, gati per fillimin e punimeve. Çdo pune e bere jasht akseve, kuotave dhe kufijve te treguara ne vizatime ose te mosmiratuara nga Punedhenesi, nuk do te paguhet, dhe Sipermarresi do te mbuloje me shpenzimet e tij germimet shtese.

Mbrojtja e ambientit

Sipermarresi, me shpenzimet e veta, duhet te ndermarre te gjithe veprimet e mundshme per te siguruar qe ambienti lokal i sheshit te ruhet dhe qe vijat e ujit, toka dhe ajri (duke perfshire edhe zhurmat) te jene te pastra nga ndotja per shkak te punimeve te kryera . Mos plotesimi i kesaj klauzole ne baze te evidentimit nga Investitori mund te coje ne nderprerjen e kontrates.

Transporti dhe magazinimi i materialeve

Transporti i cdo materiali nga Sipermarresi do te behet me makina te pershtateshme te cilat kur ngarkohen nuk shkaktojne derdhje dhe e gjithe ngarkesa te jetë e siguruar. Ndonje makine qe nuk ploteson kete kerkese ose ndonje nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do te hiqet nga kantjeri. Te gjitha materialet qe sillen nga Sipermarresi, duhet te stivohen ose te magazinohen ne menyre te pershtateshme per ti mbrojtur nga rreshqitjet, demtimet, thyerjet, vjedhjet dhe ne dispozicion, per tu kontrolluar nga Investitori ne çdo kohe.

Pastrimi perfundimtar i zones

Ne perfundim te punes, sa here qe eshte e aplikueshme Sipermarresi, me shpenzimet e tij, duhet te pastroje dhe te heqe nga sheshi te gjitha impiantet ndertimore, materialet qe kane tepruar, mbeturinat, skelerite dhe ndertimet e perkoheshme te cdo lloji dhe te lere sheshin e tere dhe veprat te pastra dhe ne kondita te pranueshme.

SHENIM: Per çdo paqartesi gjate zabatimit te punimeve te thirret inxhinieri i projektit.

Projektoi ing. A.Marini